NR. 16, QERSHOR 2023 | Viti II

Revistë e përmuajshme (politike-diplomatike)

# ARGUMENTUM

news opinion analysis



## ‘ASHRAF 3’ CËNON SIGURINË E SHQIPËRISË

# Kryeministri Edi Rama: Nëse muxhahedinët e ‘MEK’ duan luftë, duhet të largohen nga Shqipëria

ARGUMENTUM
news opinion analysis

## Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

**Argumentum.al** tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online.
Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji.
Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.
**Argumentum.al** përpiqet të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare, politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpuntorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexueseve të saj.
Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

**“Argumentum”, një proces intelektual …**

**Marjana DODA**
**Kryeredaktore**

# Përmbajtja


**03 EDITORIAL**
- ‘ASHRAF 3’ cënon sigurinëe Shqipërisë/ Kryeministri Rama: Nëse muxhahedinët e ‘MEK’ duan luftë, duhet të largohen nga Shqipëria.

**07 JO VETEM LAJM**
- Fjalimi historik në PE/ Presidentja Vjosa Osmani: Liri, Pavarësi, Demokraci! - Kosova është Evropë, dhe të jesh kosovar do të thotë të jesh evropian.
- Edward Joseph: SHBA po krijon krizë në Kosovë!

**11 POLITIKË**
- Përfundimi i mandatit/ Kryeministri Rama nderon Ambasadoren Yuri Kim me Yllin e Madh të Mirënjohjes Publike

**13 FOKUS**
- Moska përballet me një luftë civile? Presidenti Putin i quan “tradhti” veprimet e grupit Wagner brenda Rusisë.

**15 RAJONI**
- Rrëmbimi i tre policëve në veri të Kosovës/ Reagime në Shqipëri, Kosovë dhe nga ndërkombëtarët.
- 5 vite nga Marrëveshja e Prespës/ Ish Kryeministri Zaev: Marrëveshja e Prespës solli stabilitet dhe siguri.
- Takimi me kryeministrin Kurti/ Escobar dhe Lajçak: Ulje tensionesh, zgjedhje të reja në veri të Kosovës dhe kthim në tryezën e bisedimeve.
- Lëvizja Evropa Tani fiton zgjedhjet në Mal të Zi.

*ENGLISH EDITION*

**23 REALPOLITIK**
- No “ carrot” for Belgrade and “ stick” for Pristine! An unnecessary draft! Nor did Gjakova unite us!

**26 ENGLISH TOP NEWS**
- Rama warns the Mujahideen that if they want war, they should leave Albania.

**27 IN FOCUS**
- Albania and China share common wish to promote overall bilateral cooperation.

**28 BALKAN OVERVIEW**
- Rama steps up his effort to get involved in the mediation process of talks between Kurti and Vucic
- Albania’s President attends commemorations of the 145th anniversary of the League of Prizren.

**30 GLOBAL**
- Former Italian Prime Minister Silvio Berlusconi dies aged 86between Kurti and Vucic.
- Erdogan announces new cabinet.

# ‘ASHRAF 3’ CËNON SIGURINË E SHQIPËRISË

## Kryeministri Rama: Nëse muxhahedinët e ‘MEK’ duan luftë, duhet të largohen nga Shqipëria

Që në orët e para të mëngjesit të 20 qershorit, Policia e Shtetit në Shqipëri kreu kontrolle në mjediset ku janë të strehuar rreth 3.000 pjesëtarë të opozitës iraniane, në kampin e Manzës të Durrësit.

Sipas njoftimit, policia tha se kontrollet po kryhen me vendim të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe urdhër të Strukturës së Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK).

Përfaqësuesit e Organizatës së Muxhahedinëve të Popullit të Iranit (MEK), thanë se një person ka humbur jetën si pasojë e përdorimit të gazit lotsjellës nga policia.

Sipas MEK disa të tjerë u plagosën si pasojë e ndërhyrjes së policisë. Këto pretendime u rrëzuan nga Ministria e Brendshme në Shqipëri.

“Ndërhyrja e Policisë së Shtetit ka qenë konform ligjit dhe në zbatim korrekt të procedurave që kërkojnë operacione të tilla. Veprimet e Policisë së Shtetit për zbatimin e ligjit janë kryer si në çdo pjesë tjetër të territorit të Republikës së Shqipërisë. Fatkeqësisht, brenda kampit ka pasur rezistencë ndaj kryerjes së punës së Policisë së Shtetit”, u tha në njoftimin e Ministrisë së Brendshme shqiptare.

Sipas kësaj ministrie, kontrollet kanë qenë të detyrueshme, pasi organizata MEK ka shkelur marrëveshjen që ka nënshkruar me Shqipërinë më 2014.



> “Vendimi i gjykatës është pasojë e veprimeve që bien haptazi ndesh me marrëveshjen dhe angazhimet e marra nga grupimi MEK prej vitit 2014 kur u vendosën në Shqipërim vetëm për qëllime humanitare.

“Vendimi i gjykatës është pasojë e veprimeve që bien haptazi ndesh me marrëveshjen dhe angazhimet e marra nga grupimi MEK prej vitit 2014 kur u vendosën në Shqipërim vetëm për qëllime humanitare. Fatkeqësisht ky grupim nuk iu është përmbajtur këtyre angazhimeve duke thyer marrëveshjen”, tha Ministria e Brendshme.

Policia tha më herët se kontrollet po kryhen duke respektuar etikën dhe komunikimin, si dhe liritë dhe të drejtat themelore të të gjithë qytetarëve dhe komunitetit që banon në këtë kamp.

# Kryeministri Rama për 'Der Spiegel': Nëse muxhahedinët e 'MEK' duan luftë, duhet të largohen nga Shqipëria




Kryeministri Edi Rama ka reaguar për herë të parë për aksionin e Policisë së Shtetit në kampin e muxhahedinëve me urdhër të SPAK dhe firmosur nga Gjykata Speciale. më 20 qershor 2023.

Në një intervistë për median gjermane Der Spiegel tha se muxhahedinët nuk mund ta përdorin Shqipërinë për të luftuar kundër regjimit iranian.

**SPIEGEL:** Zoti Rama, javën e kaluar Forcat e sigurisë pranë Tiranës zhvilluan operacion në kampin e MEK-ut iranian. Pse?

**Rama:** MEK-un e kemi prej disa vitesh në vendin tonë. Ata janë të mirëpritur, por me kusht që mos ta përdorin Shqipërinë si një platformë për operacionet e tyre politike. Mysafirët tanë iranianë e kanë shkelur vazhdimisht këtë marrëveshje.

**SPIEGEL:** Kompjuterët e qeverisë në Teheran janë hakuar dhe kanë qarkulluar dokumente të ndjeshme. Rreth 100 PC dhe dhjetëra Hard disqet thuhet se janë konfiskuar tani. Mund ta konfirmoni këtë?

**Rama:** Shqipëria nuk ka synim të jetë në luftë me regjimin iranian. Shqipëria nuk pranon askënd që ka abuzuar me mikpritjen tonë.

Spiegel: Pse pranuat me kërkesë të presidentit amerikan Barack Obama në vitin 2016 për të pranuar mijëra muxhahedinë?

Rama: Ishte një operacion jetëshpëtues. Ne hapëm dyert tona sepse grupi, që atëherë vepronte nga Iraku u ndoq sistematikisht. Dhe nëse një mik si SHBA-ja na kërkon diçka, ne ndihemi të nderuar.

**SPIEGEL:** Nëse do të ishit MEK do preferonit të largoheshit?

**Rama:** E kuptojmë inatin kundër regjimit në vendin e tyre. Por vendi ynë të përdoret si llogore në një luftë që nuk është e jona, nuk funksionon! Sigurisht që ata kanë çdo të drejtë të luftojnë për lirinë e tyre, por për ta bërë këtë duhet të largohen nga Shqipëria.



E kuptojmë inatin kundër regjimit në vendin e tyre. Por vendi ynë të përdoret si llogore në një luftë që nuk është e jona, nuk funksionon! Sigurisht që ata kanë çdo të drejtë të luftojnë për lirinë e tyre, por për ta bërë këtë duhet të largohen nga Shqipëria.



Kontrolli i policisë në mjediset dhe zyrat e kampit u bazua në zbatimin e një vendimi të Gjykatës së Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsioni.

Burime zyrtare pohuan të mërkurën, (21.06) se vendimi për të kontrolluar kampin e muxhahedinëve u mbështet në dyshime se anëtarët e organizatës MEK, të strehuar në këtë kamp, kanë kryer nga territori i Republikës së Shqipërisë sulme kibernetike ndaj Republikës Islamike të Iranit dhe disa institucioneve në shtetin iranian.




Për pasojë Republika Islamike e Iranit kërcënon se do të ndërmarrë sulme kibernetike ndaj Shqipërisë dhe muxhahedinëve të strehuar në Shqipëri" citojnë burimet vendimin e Gjykatës.

Në shtator të vitit të kaluar qeveria e Tiranës mori vendimin për ndërprerje me efekt të menjëhershëm të marrëdhënieve diplomatike me Republikën Islamike të Iranit, bazuar në "prova të pakundërshtueshme për sulme kibernetike pas të cilave fshihej Irani", theksonte vendim i qeverisë.

Vitin e kaluar, për arsye sigurie nga kërcënime terroriste nuk u zhvillua në kampin e muxhahedinëve „Ashraf 3ç në Manëz, Samiti Botëror i Iranit të Lirë.

Marrëveshja SHBA – Shqipëri në shërbim të paqes

Marrëveshja mes SHBA dhe Shqipërisë për pranimin e muxhahedinëve u nënshkrua në vitin 2012 kur qeveria amerikane e hoqi organizatën e muxhahedinëve nga lista e organizatave terroriste. Muxhahedinët u morën nën mbrojtjen e SHBA pas ndërhyrjes së tyre të armatosur në Irak në vitin 2003 dhe mbështetjes që muxhahedinët u dhanë operacioneve ushtarake amerikane në Lindjen e Mesme dhe luftës kundër terrorizmit. Strehimi i tyre në Shqipëri filloi në vitin 2013 dhe u konsiderua nga autoritetet si „një shërbim ndaj paqes dhe stabilitetit në rajon, angazhim i Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s."

Lidhur me mundësinë e prishjes së marrveshjes dhe dëbimin e muxhahedinëve nga Shqipëria, ambasadorja amerikane Yuri Kim, tha në konferencëm për




shtyp që vendimi për këtë i takon qeverisë së Shqipërisë.

"SHBA mbështesin Shqipërinë në të drejtën e saj për të zbatuar ligjet e saj, në vendin e saj" – tha ambasadorja amerikane, Yuri Kim, e cila e ka përfunduar mandatin e saj në Shqipëri dhe nis detyrën e zëvendësndihmëse, sekretare kryesore për Çështjet Evropiane në Departamentin Amerikan të Shtetit.

MPJ e Iranit: Muxhahedinët kërcënim për sigurinë e Shqipërisë

Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme të Iranit, Nasser Kana'ani, citohet nga mediat e Tiranës të ketë deklaruar që "muxhahedinët do të jenë gjithmonë një kërcënim për sigurinë e Shqipërisë pasi janë terroristë". Ai citohet gjithashtu t'u ketë bërë thirrje autoriteteve të Tiranës "ta marrin në konsideratë këtë kërcënim".

Marrëveshja SHBA-Shqipëri për pranimin e muxhahedinëve u nënshkrua në vitin 2012Fotografi: mojahedin.org

Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH) e ka përkrahur aksionin policor të Shqipërisë më 20 qershor, kur Policia e Shtetit kreu kontrolle në kampin e Manzës, ku janë strehuar pjesëtarë të opozitës iraniane.

DASH-mbështet Policinë e Shtetit

Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH) përmes një zëdhënësi të tij citohet të ketë thënë se "SHBA mbështesin të drejtën e qeverisë së Shqipërisë për të hetuar çdo veprimtari të mundshme të paligjshme brenda territorit të saj".

Zëdhënësi i DASH-it thekson që "SHBA-ja nuk e cilëson organizatën e muxhahedinëve, MEK, lëvizje opozitare të qëndrueshme dhe demokratike që përfaqëson popullin iranian".

Më 2013, autoritetet shqiptare janë pajtuar – me kërkesë të Shteteve të Bashkuara – që të pranojnë rreth 3.000 pjesëtarë të Organizatës së Muxhahedinëve të Popullit të Iranit (MEK).

Irani i konsideron pjesëtarët e kësaj organizate si terroristë. Shqipëria ka ndërprerë marrëdhëniet diplomatike me Iranin, pasi e fajësoi Iranin se qëndron prapa një sulmi kibernetik që ndodhi në korrik të vitit 2022. Ndërkaq një vit më parë u anulua, për arsye sigurie nga kërcënime terroriste, Samiti Botëror i Iranit të Lirë, që do të mbahej më 23 dhe 24 korrik në "Ashraf 3" në Manzë të Durrësit.



FJALIMI HISTORIK NË PE

## Presidentja Vjosa Osmani: Liri, Pavarësi, Demokraci!

# Kosova është Evropë, dhe të jesh kosovar do të thotë të jesh evropian



***Liri, Pavarësi, Demokraci. Freedom, Independence, Democracy. Liberté, Indépendance, Démocratie.***

Me këto fjalë në shqip, anglisht dhe frengjsht Presidentja e Republikës së Kosovës, i drejtohet seancës plenare të Parlamentit Evropian për herë të parë si shtet i pavarur. Ky adresim i Osmanit është i pari që prej shpalljes së Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008.

Presidentja Vjosa Osmani, iu drejtua sot me një fjalim, Parlamentit Evropian. Fjalimin e mbajti me ftesë të presidentes së këtij parlamenti, Roberta Metsola.

Në adresimin e saj në sesionin plenar të Parlamentit Evropian, Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani përmendi fjalët emblematike të presidentit historik, dr.Ibrahim Rugova "Liri, Pavarësi, Demokraci".

Sipas presidentes Osmani, këto fjalë ishin vizioni i popullit të Kosovës, i cili u bë realitet.

"Sot ai vizion i Rugovës, heronjve tanë dhe popullit tonë është realitet. Kosova sot është e lirë. Kosova sot është e pavarur. Dhe Kosova sot është një fener i demokracisë", ka theksuar Presidentja Osmani para eurodeputetëve në adresimin e saj.

Përgjatë adresimit të saj, Presidentja Osmani riktheu në kujtesë periudhën e para 25 vjetëve më parë kur presidenti Rugova, atëkohë fitues i çmimit Saharov mbajti fjalim në PE.

"Presidenti Rugova e konsideroi çmimin si njohje të sakrificës së popullit të Kosovës dhe luftës së tij për liri, por më e rëndësishmja ai përdori pikërisht këtë platformë për të kërkuar mbështetjen e deputetëve të atëhershëm për t'u bashkuar në emër të vlerave të cilat ky Union i përfaqëson. Ai kërkoi që Evropa të bashkohej në mbrojtje të një populli të shtypur", theksoi Presidentja Osmani.

Sipas Presidentes Osmani ky fjalim i dha shpresë popullit të Kosovës.

Kosova është Evropë, dhe të jesh kosovar do të thotë të jesh evropian. Republika jonë e re lindi nënritmin dhe tingujte Evropës. Kur Kosova shpalli pavarësinë

më 17 shkurt 2008, në mungesë të himnit shtetëor, himni evropian jehoi në institucionet, sheshet dhe rrugët e vendit tim.
Ashtu si shpirti i patrembur i një Republike të sapolindur, himni "Ode of Joy" rezononte me ndjenjat që mbartnim në zemrat dhe shpirtrat tanë, duke adhuruar dhe përqafuar idealet e lirisë, paqes dhe solidaritetit. Të vendosur për t'iu bashkuar familjes evropiane të kombeve dhe të frymëzuar nga Bashkimi Evropian, gjetëm prehë dhe unitet në gjuhën universale të muzikës.
Ky akt shkoi përtej simbolizmit; ishte deklarata jonë për botën se Bashkimi Evropian ishte destinacioni ynë i drejtë dhe një thirrje për institucionet evropiane që të përqafojnë aspiratat tona të palëkundura.
"Evropa jo vetëm që ia kishte hapur dyert Presidentit Rugova, por kishte hapur zemrat dhe mendjet e saj për një popull të shtypur sistematikisht. Sot, duke qëndruar këtu në Strasburg, kam nderin të jem presidentja e parë e Republikës së pavarur të Kosovës që do të flas para Parlamentit Evropian, për t'ju falënderuar për kontributin e pamasë dhe të vazhdueshëm që ky institucion ka dhënë për lirinë, demokracinë tonë dhe pavarësinë", është shprehur ndër të tjera Presidentja Osmani.
Para eurodeputetëve, Presidentja Osmani, duke kërkuar mbështetjen e PE-së në rrugën evropiane të Kosovës, rikujtoi thënien e presidentit Rugova: "Shtëpia nuk mbahet pa miq" dhe në këtë kontekst, shprehu mirënjohjen e popullit të Kosovës për mbështetjen e palëkundur dhe përcaktimin se Bashkimi Evropian është destinacioni Kosovës.

**Presidentja Osmani tha se Kosova ka histori të trishtë dhe sfiduese, por edhe vendosmëri për një të ardhme më të mirë.**

Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani në adresimin e saj në seancë plenare në Parlamentin Evropian ka rrëfyer historinë e Kosovës nëpërmjet fateve personale të: Vasfije Krasniqit, Fahrije Hotit, Blerta Bashollit, Egzon Sylës, Hana Qerimit dhe gazetares ukrainase Liudmyla Makei, të cilët janë pjesë e delegacionit të Presidentes në këtë adresim.
"Historitë individuale të gati 2 milionë njerëzve, e bëjnë Kosovën suksesin që është sot", ka theksuar Presidentja Osmani.
Gjatë prezantimit të delegacionit, Presidentja Osmani, spikati të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen e Kosovës nëpërmjet rrëfimeve jetësore të anëtarëve të delegacionit.
"Ky është përfaqësimi i vërtetë i Republikës sonë të dashur – që përfaqëson historinë e trishtë dhe sfiduese të Kosovës, si dhe frymën e qëndrueshmërisë, këmbënguljes dhe vendosmërisë që është një premtim për një të ardhme më të madhe", ka theksuar ndër të tjera Presidentja Osmani.
Presientja Osmani tha se Vasfije Krasniqi Goodman ishte ajo që e kuptoi se plagët thellohen në heshtje.
"Sot ajo është zëri i mijëra të mbijetuarve të dhunës seksuale të kohës së luftës në Kosovë", tha ndër të tjera Presidentja Osmani.
Më tej, në adresimin e saj, Presidentja Osmani shpalosi edhe fatin jetësor të znj.Fahrie Hoti.
"Ajo e ktheu pikëllimin në motivim, ajo e ktheu dhimbjen në vendosmëri", shtoi presidentja Osmani.
Veprimet e saj, sipas Presidentes Osmani, jo vetëm që shpëtuan jetën e qindra grave në fshatin e saj, por historia e saj frymëzoi edhe filmin "Zgjoi", të regjisores Blerta Basholli.
Duke folur për një të ardhme më të mirë, Presidentja veçoi rrëfimin e suksesshëm të Hana Qerimit, bashkëthemeluese e Digital School dhe StarLabs, dy kompani, të cilat janë etabluar në tregun evropian me punën që bëhet në Kosovë.
Historitë e këtyre njerëzve, sipas Presidentes Osmani janë mishërimi i qëndrueshmërisë.
Në këtë kontekst, Presidentja përmendi angazhimin e Egzon Sylës, nga kontingjenti i Kërkim-Shpëtimit në FSK, i cili ka udhëhequr ekipin në përpjekjet e shpëtimit nga pasojat e tërmetit shkatërrues në Turqi.
"Sot, një 2-vjeçar si dhe të tjerë janë ende gjallë për shkak të Egzonit dhe ekipit të tij. Përkushtimi dhe profesionalizmi i tyre tregon shpirtin e vërtetë të popullit të Kosovës: atë që nuk dorëzohet kurrë dhe që jep gjithmonë", tha Presidentja Osmani.
Në fjalimin e saj, Presidentja prezantoi edhe rrëfimin e Liudmyla-n. Liudmyla Makei, gazetarja e parë ukrainase që u prit në Kosovë si pjesë e Programit të Gazetarëve në Rezidencë në Kosovë të nisur nga institucionet kosovare në mbështetje të kauzës së tyre për të mbrojtur të vërtetën.
"Populli im e njeh edhe ndjenjën e pakrahasueshme të lirisë dhe paqes. Dhe, shpresoj se populli i Ukrainës së shpejti do t'i përjetojë këto ndjenja ndërsa e fiton luftën ndaj agresionit të Rusisë", ka thesuar ndër të tjera Presidentja Osmani.

# Pjesë nga fjalimi i Presidentes Osmani në PE



E nderuara Presidente Metsola,
Të nderuar deputetë të Parlamentit Evropian,
Të dashur miq të Kosovës,
Fjalimin tim sot e nisa me Presidentin Rugova dhe dua ta përfundoj me një tjetër fitues të çmimit Saharov nga Kosova, Adem Demaçin, i cili kaloi gati 3 dekada të jetës së tij në burg për shkak të luftës së tij për një Kosovë të lirë ku respektohen të drejtat e njeriut, për të gjithë. Duke folur me rastin e marrjes së çmimit në vitin 1991, ai tha: "Duke më nderuar mua, ju po nderoni popullin e Kosovës, një popull paqedashës dhe liridashës që po kalon vuajtje të mëdha".
Sot, zonja Presidente, të nderuar deputetë, dua t'ju falënderoj që më keni dhënë nderin e madh të jem zëri i popullit të Kosovës para këtij institucioni të çmuar.
Shpresoj që kjo seancë plenare të ketë shërbyer si një takim mendjesh, një ribashkim miqsh dhe një testament për atë që ne përpiqemi të bëhemi. Ndërsa synojmë për një të ardhme më të mirë dhe më të ndritshme për të gjithë, nuk duhet të harrojmë kurrë se nga kemi ardhur. Duhet të kujtojmëgjithmonë se si arritëm këtu dhe kush na qëndroi pranë në kohë gëzimi dhe pikëllimi.
Zgjodha të flas edhe për të kaluarën tonë, sepse ajo ka formësuar të tashmen tonë dhe mbetet jetike teksa krijojmë të ardhmen tonë.
Zgjodha të flas për vlerat e BE-së, sepse janë këto vlera që shërbejnë si busullë morale e jona dhe na udhëheqin ne dhe njerëzit tanë drejt majave më të larta të arritjeve njerëzore.
Unë kam folur sot se sa shumë ndajmë me BE-në – si Kosova ashtu edhe Ukraina – sepse dy vendet tona, pavarësisht distancës, ndajnë një histori pikëllimi në tokën e përbashkët evropiane, por një të ardhme me potencial dhe mundësi të mëdha në familjen e përbashkët evropiane.
Asgjë nuk e ilustron këtë më fuqishëm sesa ngjyrat e përbashkëta të flamujve tanë – e kaltërta dhe e verdha. Dy ngjyra që tregojnë një histori.
Qielli blu dhe dielli i verdhë.
Së bashku, këto ngjyra përfaqësojnë shpresën për një agim të ri.
Për Ukrainën dhe për Kosovën, ai agim i ri është një paqe e drejtë dhe anëtarësim në Bashkimin Evropian.
Për Evropën, është forca e shtuar nga aleancat e reja dhe uniteti.
E kaltra dhe e verdha, ngjyrat e Kosovës, ngjyrat e Ukrainës, ngjyrat e Evropës, ngjyrat e lirisë.
Faleminderit.

# Edward Joseph: SHBA po krijon krizë në Kosovë!



Ish-zëvendësshefi i misionit të OSBE-së në Kosovë, Edward Joseph, vlerëson se SHBA është duke krijuar një krizë në Kosovë. Profesori amerikan, në një opinion të publikuar në "Foreign Policy", thekson se Sekretari Amerikan i Shtetit, Antony Blinken, duhet të vendosë nëse "ia vlen ky çrregullim rajonal dhe dëmtim i reputacionit të SHBA-së, për ta kënaqur një autokrat serb".

"Blinken duhet ta mbyllë turneun e tij në Bruksel, me Borrellin e përfaqësuesin special të BE-së për rajonin, Miroslav Lajçak. Blinken duhet t'ua kujtojë diplomatëve se marrëveshja mes Serbisë dhe Kosovës mban emrin e BE-së. Brukseli nuk mund të fshihet më prapa linjës se është thjeshtë lehtësues. SHBA-ja dhe BE-ja, në vend të një "paqartësie konstruktive", duhen të përqendrohen në qartësi. Është urgjencë një sekuencim i hekurt i hapave që Kosova dhe Serbia duhet të ndërmarrin për ta zbatuar marrëveshjen, dhe atë duhet ta bëjnë shpejt brenda këtij viti", shkruan Joseph.

"Në këtë mënyrë Blinken do t'i largojë SHBA-në dhe BE-në nga konfuzioni dhe kriza, duke i dërguar sinjal Moskës për vendosmërinë për të konsoliduar Ballkanin në Perëndim, përkrah Ukrainës".

Joseph shkruan se presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky, mund ta kuptojë më së miri këtë ngecje mes SHBA-së dhe Kosovës. "Kërkojini presidentit ukrainas t'u japë autonomi rusëve etnikë, dhe ai menjëherë do të bëjë këto tri pyetje: A do ta pranojnë rusishtfolësit se jetojnë në Ukrainë e jo Rusi? A do ta njohë Rusia sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës? Dhe nëse ofrohet kjo autonomi, a do të pranohet Ukraina më në fund në NATO?".

Joseph shkruan se paaftësia e SHBA-së dhe Bashkimit Evropian për t'iu përgjigjur këtyre tri pyetjeve të njëjta edhe në rastin e Kosovës e Serbisë, është arsyeja prapa "luftës" mes perëndimorëve dhe kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti.

Joseph shkruan se Uashingtoni dhe Brukseli ndajnë fajin për krizën, duke përfshirë këtu edhe dhunën e ushtruar nga serbët kundrejt paqeruajtësve të NATO-s.

"Absurditeti i sanksionimit të një aleati demokratik në Prishtinë, e në anën tjetër përshëndetja e një autokrati manipulues e pro-rus, të cilin ambasadori amerikan në Serbi, Christopher Hill e quajti 'partner më të mirë të SHBA-së', duhet ta bëjë Blinken të pushojë pak. Në vend që ta lejojë frustrimin që ta drejtojë politikën e tij karshi Kosovës, apo që ta lejojë iluzionin ta drejtojë politikën e tij karshi Serbisë, Blinkeni duhet të rishqyrtojë urgjentisht qasjen e administratës së tij", vlerëson Joseph.

"Si fillim, administrata e Biden duhet t'i "disiplinojë" ambasadorët e saj në rajon, duke "shkurtuar" ekskursionet e Hill në politikat e një vendi, Kosovës, që nuk është më pjesë e Serbisë", këshillon ai.

"Blinken duhet të mbajë një fjalim të konsideruar thellë për politikën e SHBA në Serbi, Kosovë dhe në të gjithë rajonit. Blinken duhet t'i rivendosë në qendër vlerat demokratike si bërthama e politikës së SHBA dhe partneritetit me Evropën. Ai duhet t'i orientojë emisarët dhe ambasadorët e tij që t'u japin këtë mesazh liderëve të Ballkanit, duke përfshirë Vuçiçit," shkruan Joseph.

# Përfundimi i mandatit/ Kryeministri Rama nderon Ambasadoren Yuri Kim me Yllin e Madh të Mirënjohjes Publike

## Kryeministri Edi Rama: Yuri Kim ishte më amerikania mes shqiptarëve dhe më shqiptarja mes amerikanëve”

Në përfundim të misionit diplomatik të ambasadores Kim në Shqipëri, Rama i kushtoi një shkrim në rrjetet sociale, ku ndër të tjera shprehu mirënjohjen e falenderimin për ambasadoren Kim.



“Yuri Kim e mbylli misionin e saj në Shqipëri. Ajo qëndroi njësoj sa të gjithë ambasadorët e tjerë, po qëndrimi i saj zgjati më shumë se sa i të tërë të tjerëve bashkë. Sepse ndryshe nga gjithë të tjerët, ajo nuk ndenji një ditë pa u shfaqur, sa ekran më ekran, e vrenjtur edhe kur buzëqeshte, sa në instagram, e qeshur edhe kur peizazhet nga Shqipëria ishin të vranëta, e sa përmes cicërrimave, ku ëmbëlsisht serioze e ku seriozisht të hidhura, nga frëngjia e Twitterit; sa në rrugët e jetës politike në Tiranë, ku me dylbi e me pushkë në stërvitjet ushtarake, ku me shpatë në brez në mbledhjet e organeve të drejtësisë, ku me lot në sy për viktimat e Armikut të Padukshëm, ku me helm në gjuhë për armiqtë e Reformës në Drejtësi, e ku me llokume e raki për komisionin multipartizan të reformës zgjedhore”, shkruan Rama.

“Herë si kalorëse e të gjithëpushtetshmit, herë si hije e pushtetit dhe herë si bebisiter e kundërshtarëve të pushtetit, edhe falenderuese për miqësinë mes popujve, edhe inkurajuese për arritjet e popullit, edhe kërcënuese për të zgjedhurit nga populli, nganjëherë e bezdisur prej akuzave se po mbështet qeverinë, ndonjëherë e nervozuar prej pretendimeve se po mbështet opozitën, shpeshherë e gëzuar për pakënaqësinë e të gjitha palëve, po asnjëherë në një vend; sa në majat e maleve e në brigjet e deteve, për të dhënë mesazhe të mirëkuptuara, sa në mes të burrave me kostum për të nënkuptuar se kostumi s’të bën medoemos burrë, sa në këmbë



mes fëmijëve në Tropojë për të nënvizuar se Amerika s'të njeh për burrë, e sa ulur mes plakave në Dhërmi, për të nëntreguar se asnjë burrë nuk është i domosdoshëm", vijon kryeministri.
Rama u shpreh se "Yuri Kim u largua duke lënë pas në pamje të parë, miq e armiq, që e deshën apo e urryen, ndërkohë që më pranë të vërtetës është fakti se askush s'e deshi dot pa e urryer asnjëherë dhe asnjë s'e urreu dot pa e dashur qoftë edhe njëherë".
Sipas tij, "në radhën e tërë atyre që deri më sot janë ulur në zyrën e ambasadorit amerikan në Shqipëri, ajo ishte më amerikania mes shqiptarëve dhe më shqiptarja mes amerikanëve".
"Kush më shumë e kush më pak, ambasadorët e superfuqisë në vendin tonë kanë rënë në kurthin e ëmbëlsisë admiruese të Shqipërisë, ku Amerika shihet si Arusha e Madhe në qiell dhe një ambasador amerikan trajtohet kudo ku shkon, si mik i rënë nga qielli, e për rrjedhojë fatale bie brenda dhe ndjehet si një Zot në tokë, i cili duhet të jetojë e të veprojë në emër të popullit shqiptar, të bëhet jo vetëm zëdhënësi i halleve të tij, po edhe luftëtari që për llogari të tij përleshet me padrejtësitë, fshikullon të pushtetshmit, godet të paudhët, poshtëron të pandreqshmit, një lloj gjykatësi suprem, i cili merr frymë me detyrimin moral karshi njerëzve të thjeshtë që të kontestojë deri edhe vetë vendimet e gjykatave", shtoi Kryeministri.
"E tmerrshme në dukje, po jo edhe aq në fakt, sepse për ta vlerësuar si duhet rolin e ambasadorëve amerikanë, e posaçërisht të ambasadores që me protagonizmin e saj të veçantë na doli edhe në ëndërr, e më shtyu t'i shkruaj edhe këto radhë, duhet bërë pyetja, "A do të ishte më mirë sikur të mos ishin fare a sikur në vend se të zhytej me kokë, në vorbullën e jetës politike e institucionale të vendit, Yuri të qëndronte si sfinks mbi kodrën e butë të Rrugës së Elbasanit?"….
Unë them jo, padiskutim jo. Përkundrazi. Por ky do të ishte një shkrim i gjatë, për të cilin këtu nuk është asfare vendi", vijoi ai.
Rama u shpreh se: "Në fund të misionit të saj, nuk më mbeti tjetër veçse t'i dorëzoj ambasadores Yuri Kim, Yllin e Madh të Mirënjohjes Publike për sa shumë e deshi Shqipërinë, sa shumë u përpoq për të ndihmuar që Shqipëria në ikje të saj, të bëhej një vend më i mirë se sa ai që ishte kur ajo erdhi dhe mbi të gjitha, për bindjen time se kjo lloj Amerike, me duart e futura në organizmin e jetës sonë institucionale, ka qenë tërë këto vite të ngjitjes së mundimshme nga honi i zi i ferrit komunist në të përpjetën drejt dritës së demokracisë, një e keqe aq e domosdoshme, sa vetë forca që i ka dhënë Shqipërisë e kombit shqiptar në çdo drejtim, e padyshim edhe sa fuqia që i ka dhënë drejtësisë në Shqipëri për të luftuar, më në fund, me të këqijat që deri dje ngjanin të përjetshme dhe pa Amerikën në krah do të mbeteshin përjetë të tilla".
"Prandaj njësoj si këta rreshta mbase diplomatikisht skandalozë – po ja që e vërteta s'është gjithnjë dot diplomatike kur duhet thënë patjetër – mirënjohja e falenderimi për ambasadoren Yuri Kim, janë të ndjerë sinqerisht e të menduar krejt lirisht, teksa avioni nga Brukseli po ulet në Tiranë, ku një tjetër ambasador amerikan pritet të bjerë së shpejti në kurthin e ëmbël të Shqipërisë. Thank you for everything dear Yuri and may force be with you all the way! God Bless you and the United States of America", përfundoi Kryeministri.

# Moska përballet me një luftë civile? Presidenti Putin i quan "tradhti" veprimet e grupit Wagner brenda Rusisë



Presidenti rus Vladimir Putin u zotua të më 24 qershor të mbrojë vendin nga një kryengritje e armatosur e shpallur nga shefi i mercenarëve rusë Yevgeny Prigozhin, që presidenti Putin e quajti një "thikë pas shpine" për Rusinë.

*"Të gjithë ata që përgatitën kryengritjen do të pësojnë ndëshkimin e pashmangshëm. Forcat e armatosura dhe agjencitë e tjera qeveritare kanë marrë urdhrat e nevojshëm"*, tha Presidenti Putin në një fjalim televiziv drejtuar vendit.

Yevgeny Prigozhin, pronar i kompanisë ushtarake private Wagner, konfirmoi të shtunën në mëngjes se ai dhe trupat e tij arritën në një qytet të rëndësishëm rus pasi kaluan kufirin nga Ukraina.

Prigozhin postoi një video të tij në Rostov-on-Don në selinë ushtarake ruse që mbikëqyr luftimet në Ukrainë. Ai pretendoi se forcat e tij kishin nën kontroll objektet ushtarake në qytet përfshirë aeroportin. Video të tjera të postuara në rrjetet sociale shfaqën automjete ushtarake, duke përfshirë tanke, në rrugë.

Presidenti rus Putin e dënoi kryengritjen në një kohë kur Rusia po zhvillon "betejën më të ashpër për të ardhmen e saj" me luftën në Ukrainë. *"E gjithë makineria ushtarake, ekonomike dhe informative e Perëndimit është drejtuar kundër nesh"*, tha ai.

> "Të gjithë ata që përgatitën kryengritjen do të pësojnë ndëshkimin e pashmangshëm. Forcat e armatosura dhe agjencitë e tjera qeveritare kanë marrë urdhrat e nevojshëm".

Prigozhin tha se forcat e tij nuk u përballën me rezistencë nga rekrutët e rinj në pikat e kontrollit ndërsa ata kaluan në Rusi nga Ukraina, duke thënë se trupat e tij "nuk po luftojnë kundër fëmijëve".

*"Por ne do të shkatërrojmë këdo që na pengon"*, tha ai me zemërim në një sërë regjistrimesh me video dhe audio të postuara në rrjetet sociale që nga e premtja. *"Ne po ecim përpara dhe do të shkojmë deri në fund"*, tha ai.

Shërbimet ruse të sigurisë iu përgjigjen deklaratave të Prigozhinit për një kryengritje të armatosur duke kërkuar arrestimin e tij. Sa seriozisht e mori Kremlini kërcënimin dëshmon fakti se autoritetet shpallën një

"regjim kundër terrorizmit" në Moskë dhe rrethinë, duke kufizuar lirinë e lëvizjes dhe duke shtuar masat e sigurisë në kryeqytet.
Nuk ishte menjëherë e qartë se si Prigozhini ishte në gjendje të hynte në qytetin jugor rus ose sa trupa kishte me vete.
Prigozhin pretendoi se kampet e Wagnerit në Ukrainë u goditën nga raketa, helikopterë dhe zjarr artilerie me urdhër të shefit të Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralit Valery Gerasimov, pas një takimi në Rostov me ministrin e Mbrojtjes Sergei Shoigu në të cilin ata vendosën të shkatërronin Wagnerin. Ai tha gjithashtu se forcat e tij rrëzuan një helikopter ushtarak rus që qëlloi mbi një kolonë civilësh, por nuk pati një konfirmim të pavarur për këto pretendime.
Yevgeny Prigozhin tha se kishte 25,000 trupa nën komandën e tij dhe do të ndëshkonte ministrin Shoigu në një kryengritje të armatosur dhe i kërkoi ushtrisë të mos bënte rezistencë: "Ky nuk është një grusht shteti ushtarak, por një marshim për drejtësi", tha ai.
Ndërsa përfundimet e konfrontimit janë ende të paqarta, duket se ai do të pengojë më tej përpjekjet luftarake të Moskës pasi forcat e Kievit po sprovojnë mbrojtjen ruse në fazat fillestare të një kundërofensive. Mosmarrëveshja, veçanërisht nëse Prigozhini do të ngadhënjejë, gjithashtu mund të ketë pasoja për presidentin Putin dhe aftësinë e tij për të mbajtur një front të bashkuar.
Forcat e kompanisë Wagner kanë luajtur një rol vendimtar në luftën e Rusisë në Ukrainë, duke arritur të marrin qytetin ku janë zhvilluar betejat më të përgjakshme dhe më të gjata, Bakhmut. Por Prigozhini ka kritikuar gjithnjë e më shumë ushtrinë ruse, duke e akuzuar atë për paaftësi dhe për mosfurnizimin e trupave të tij me armë dhe municione.
Të premten, Komiteti Kombëtar Kundër Terrorizmit, i cili është pjesë e Shërbimit Federal të Sigurisë, FSB, akuzoi Prigozhinin për thirrje për një kryengritje të armatosur, një vepër e dënueshme deri në 20 vjet heqje lirie.
FSB-ja u kërkoi ushtarëve me kontratë të Wagnerit të arrestonin Prigozhinin dhe të refuzonin të ndiqnin "urdhrat e tij kriminalë dhe të pabesë". Organizata i cilësoi deklaratat e tij një "thikë pas shpine për trupat ruse" dhe tha se ato përbënin nxitje të konfliktit të armatosur.
Kamionë ushtarakë dhe automjete të blinduara u panë në disa pjesë të Moskës qendrore herët të shtunën, dhe ushtarët u vendosën jashtë ndërtesës kryesore të ministrisë së Mbrojtjes. Zona përreth administratës presidenciale pranë Sheshit të Kuq u bllokua.
Por me gjithë praninë e shtuar ushtarake, baret dhe restorantet në qendër të qytetit ishin plot me klientë. Në një klub afër selisë së FSB-së, njerëzit po vallëzonin kërcenin në rrugë afër hyrjes.
Prigozhini, grindjet e të cilit me ministrinë e Mbrojtjes datojnë vite më parë, kishte refuzuar të përmbushte një kërkesë që kontraktorët ushtarakë të nënshkruanin kontrata me ministrinë para 1 korrikut. Në një deklaratë të premten vonë, ai tha se ishte gati për një kompromis, por "ata kanë na mashtruan pabesisht".
*"Ata kryen një sulm me raketa në kampet tona dhe një numër i madh i shokëve tanë u vranë"*, tha Prigozhin. Ministria e Mbrojtjes mohoi të ketë sulmuar kampet e Wagnerit.
*"E keqja e mishëruar në udhëheqjen ushtarake të vendit duhet të ndalet"*, tha ai.
Gjeneral Koloneli Sergei Surovikin, zëvendëskomandant i forcave që luftojnë në Ukrainë, u kërkoi trupave Wagner të ndalonin çdo veprim kundër ushtrisë, duke thënë se kjo u shkon për shtati armiqve të Rusisë, të cilët, "po presin të shohin përkeqësimin e situatës sonë të brendshme politike".
Tatiana Stanovaya, një analiste politike, parashikoi se ky do të jetë fundi i Prigozhinit.
*"Tani që shteti është angazhuar në mënyrë aktive, nuk ka kthim prapa"*, shkroi ajo. *"Fundi i Prigozhinit dhe Wagnerit është i afërt"*.
Gjeneral-lejtënant Vladimir Alexeyev, një oficer i lartë ushtarak, denoncoi veprimin e Prigozhinit si "çmenduri" që kërcënon me luftë civile.
*"Është një thikë pas shpine për vendin dhe presidentin. …Një provokim i tillë mund të organizohej vetëm nga armiqtë e Rusisë"*, tha ai.
Ministria e Mbrojtjes tha në një deklaratë se Ukraina po përqendronte trupat për një sulm rreth Bakhmut, për të përfituar nga "provokimi i Prigozhinit". Ai tha se artileria ruse dhe avionët luftarakë po qëllonin mbi forcat ukrainase ndërsa ata po përgatisin një sulm.
Në Shtëpinë e Bardhë, zëdhënësi i Këshillit të Sigurisë Kombëtare Adam Hodge tha se "po e vëzhgojmë situatën dhe do të këshillohemi me aleatët dhe partnerët për këto zhvillime".

## RRËMBIMI I TRE POLICËVE NË VERI TË KOSOVËS

# Reagime në Shqipëri, Kosovë dhe nga ndërkombëtarët



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se "kidnapimi i tre zyrtarëve policorë brenda territorit të Republikës së Kosovës është agresion nga ana e Serbisë".

"Ky akt dëshmon edhe njëherë se Serbia nuk është e interesuar për paqe e stabilitet në rajon, por për të shkaktuar destabilizim të Kosovës dhe gjithë rajonit", tha Osmani.

"Zyrtarët policorë duhet të lirohen menjëherë dhe pa asnjë kusht", shtoi ajo.

Kryeparlamentari Glauk Konjufca tha se me këtë veprim po dëshmohet se Serbia "dëshiron të nxisë tensione mes dy vendeve".

"*Në kohën kur Qeveria e Kosovës po del me propozime për t'i gjetur zgjidhje destabilizimit të shkaktuar nga grupet kriminale të mbështetura nga Beogradi, Serbia dëshmon nuk është e gatshme për asnjë zgjidhje. Prandaj, i kërkojmë fuqishëm faktorit ndërkombëtar, veçanërisht BE-së dhe SHBA-së që ta dënojnë Serbinë për këto akte agresioni kundrejt Kosovës. Lirimi i menjëhershëm i tre policëve të Kosovës është ultimativ*", shkroi ai në Facebook.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se autoritetet dyshojnë se ky rrëmbim është bërë në shenjë hakmarrjeje.

"Dyshojmë që ata janë rrëmbyer nga ushtria e Serbisë, qartazi si hakmarrje e Serbisë për arrestimin e djeshëm të kriminelit famëkeq Millun Milenkoviqi cili paraqet një ndër krerët e krimit të organizuar dhe kontrabandës", tha Kurti.

Kryeminstri kosovar bëri thirrje për lirimin e menjëhershëm të zyrtarëve policorë dhe ftoi faktorin ndërkombëtar, të dënojë, atë që ai e quajti, "akt agresioni të Serbisë".

"*Hyrja e forcave të Serbisë në territorin e Kosovës është agresion dhe synim për eskalim dhe destabilizim*", shkroi ai në Facebook.

**REAGIME NË SHQIPËRI**

Kryeministri Edi Rama ka reaguar në lidhje me situatën e krijuar në veri të Kosovës, pas rrëmbimit të tre policëve nga forcat serbe. Sipas Kreut të Qeverisë shqiptare, ata që thonë se po heshtim, s'duan t'ia dinë as për Kosovën dhe as



**Kryeministri i Shqipërisë, EDI RAMA**

*“Kush thotë se po heshtim apo kush kërkon t’i hedhim benzinë zjarrit duke ngritur akuza ndërkohë që KFOR-i po investigon rastin, nuk do t’ia dijë as për Kosovën e as për Shqipërinë, po vetëm për luftën e stërhumbur politike me mua apo për politikën e luftës imagjinare me Serbinë”.*

për Shqipërinë, por vetëm për politikën e luftës imagjinare me Serbinë.

*“Kush thotë se po heshtim apo kush kërkon t’i hedhim benzinë zjarrit duke ngritur akuza ndërkohë që KFOR-i po investigon rastin, nuk do t’ia dijë as për Kosovën e as për Shqipërinë, po vetëm për luftën e stërhumbur politike me mua apo për politikën e luftës imagjinare me Serbinë”*, shkroi Rama në Twitter.

Rama përsëriti edhe njëherë qëndrimin e tij se Shqipëria është pjesë e bashkësisë euroatlantike dhe si e tillë ndjek të njëjtën linjë me partnerët. Ndërsa u shpreh se presin fjalën e KFOR-it që po heton rastin.

*“Prandaj më duhet edhe njëherë t’u kujtoj se Shqipëria është pjesë e bashkësisë euroatlantike dhe ka fiks të njëjtën linjë të kësaj bashkësie, e cila bombardoi Serbinë dhe krijoi shtetin e Kosovës! Ne presim fjalën e KFOR-it që po heton rastin dhe i qëndrojmë de-eskalimit imediat!*”, shkruan Rama.

## REAGIME NGA BE

Nga BE-ja thanë se janë në kontakt me Kosovën, Serbinë dhe KFOR-in për të verifikuar ngjarjet që ndodhën në vijën kufitare.

“Ne jemi – si çështje urgjente – në kontakt me të dyja palët, si dhe me KFOR-in, për të përcaktuar se çfarë dhe si ka ndodhur saktësisht”, tha zëdhënësi i BE-së, Peter Stano.

Kjo ngjarje po ndodh në kohën kur tensionet në veriun e Kosovës, të banuar me shumicë serbe, janë rritur.

Tensionet nisën më 26 maj, kur kryetarët e rinj shqiptarë të komunave në veri, nën asistimin e Policisë së Kosovës, hynë në ndërtesat komunale, mes kundërshtimeve të serbëve lokalë.

Tensionet kulmuan më 29 maj, kur në Zveçan, protestuesit serbë u përleshën me pjesëtarët e misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR. Nga përleshjet janë lënduar dhjetëra persona nga të dyja palët

